



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 03 tetor 2019
Nr. Ref.:RK 1437/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI94/19

Parashtrues

Sadik Abazi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 39/2019, të 7 marsit 2019, dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN. nr. 817/16, të 30 nëntorit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Sadik Abazi nga Komuna e Shtimes (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Kemajl Ademaj, avokat nga Ferizaj.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston:

a) Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, PN. nr. 817/16, të 30 nëntorit 2016, me të cilin i ishte refuzuar si e pabazuar ankesa e tij ndaj Aktvendimit të Gjykatës Themelore P. nr. 592/11, lidhur me llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak të parashtruesit të kërkesës; dhe

b) Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), PML. nr. 39/2019, të 7 marsit 2019, me të cilin parashtruesit të kërkesës i ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit), Pn. nr. 1070/2018, të 29 tetorit 2018 dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), Kp. nr. 1399/2018, të 2 tetorit 2018, që ia kishte hedhur poshtë si të pa lejuar kërkesën për rishikim të procedurës penale.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, me të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon që i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 7 [Vlerat], 16 [Epërsia e Kushtetutës], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E drejta për Mjete Juridike], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 11 qershor 2019, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) e pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës.
6. Më 12 qershor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
7. Më 26 qershor 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 10 shtator 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës parashtron kërkesë në Gjykatë për herë të dytë.

Faktet në lidhje me kërkesën e parë KIO6/15

10. Më 29 korrik 2011, ishte ngritur aktakuza [PPS. Nr. 460/09] në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër parashtruesit të kërkesës dhe disa personave të tjerë me pretendimin se kanë kryer disa vepra penale.
11. Më 17 dhjetor 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë [Aktgjykimi P. nr. 592/11] e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për veprën penale vrasje e rëndë.
12. Më 28 mars 2013, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës penale, shkelje të Kodit Penal dhe vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
13. Më 12 dhjetor 2013, Gjykata e Apelit [Aktgjykimi PARK 102/13] e vërtetoi në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, duke e shpallur parashtruesin e kërkesës fajtor për vrasje të rëndë.
14. Më 30 prill 2014, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatën Supreme kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke pretenduar shkelje të dispozitave përkatëse të Ligjit për procedurën penale dhe shkelje të Ligjit penal.
15. Më 3 shtator 2014, Gjykata Supreme [Aktgjykimi Pml. Kzz 98/2014] e refuzoi, si të pabazuar, kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, sepse nuk ka mundur të *“identifikojë ndonjë kundërthënie në mes të dispozitivit dhe arsytimit në asnjërin aktgjykim”* dhe për arsye se *“nuk ka pasur shkelje të dispozitave të Ligjit penal”*.
16. Me këtë Aktgjykim, Gjykata Supreme nuk ka mundur të vërtetojë kohën e saktë të kaluar në paraburgim për secilin të pandehur në procedurë, prandaj, Gjykata Supreme urdhëroi që koha e kaluar në paraburgim të vërtetohet saktë nga Gjykata e Qarkut me një aktvendim të veçantë në bazë të nenit 489 të KPP-së.
17. Më 14 janar 2015, parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatë kërkesën KIO6/15, duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. Kzz 98/2014, të 3 shtatorit 2014.
18. Më 14 korrik 2016, Gjykata përmes Aktvendimit për papranueshmëri KIO6/15 e deklaroi kërkesën e parashtruesit të papranueshme si qartazi të pabazuar në baza kushtetuese si dhe refuzoi kërkesën për masë të përkohshme.

Faktet përkitazi me kërkesën e tanishme KI94/19

19. Në lidhje me kërkesën KI94/19, parashtruesi gjithashtu zhvilloi dy procedura, dhe atë: i) procedurën lidhur me llogaritjen e kohës të cilën e kishte kaluar në arrestin shtëpiak dhe ii) procedurën në lidhje me kërkesën për përsëritje të procedurës penale.

Faktet përkitazi me procedurën lidhur me llogaritjen e kohës që parashtruesi i kërkesës e ka kaluar në arrest shtëpiak

20. Më 29 mars 2016, duke vepruar sipas urdhrin të Gjykatës Supreme, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin e veçantë [P. nr. 592/2011] lidhur me llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak të parashtruesit të kërkesës dhe disa personave të tjerë në procedurë.
21. Gjykata Themelore vërtetoi se koha të cilën parashtruesi i kërkesës e kishte kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak ishte nga 27 korriku 2011 deri më 12 dhjetor 2013.
22. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë kundër Aktvendimit [P. nr. 592/2011] të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike sa i përket llogaritjes së paraburgimit dhe arrestit shtëpiak, duke pretenduar se ai ka qëndruar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga 28 korriku 2011 deri më 26 mars 2015.
23. Më 30 nëntor 2016, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [PN. nr. 817/16], refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.

Faktet përkitazi me procedurën sipas kërkesës së parashtruesit të kërkesës për rishikimin e procedurës penale

24. Më 11 shtator 2018, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesë për rishikimin e procedurës penale në Gjykatën Themelore, duke kërkuar rishikimin e Aktvendimit [P. nr. 592/2011] të Gjykatës Themelore, të 29 marsit 2016, dhe Aktvendimit [PN. nr. 817/16] të Gjykatës së Apelit, të 30 nëntorit 2016, dhe llogaritjen e saktë të kohës së kaluar në paraburgim të parashtruesit të kërkesës.
25. Më 2 tetor 2018, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [Kp. nr. 1399/2018] hodhi poshtë si të palejuar kërkesën e parashtruesit për rishikim të procedurës penale duke arsyetuar se ky mjet juridik lejohet vetëm kundër aktvendimeve të formës së prerë dhe aktgjykimeve të formës së prerë me të cilat pushohet procedura penale.
26. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë ndaj Aktvendimit [Kp. nr. 1399/2018] të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal.

27. Më 29 tetor 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit (PN. nr. 1070/2018) refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit [Kp. nr. 1399/2018] të Gjykatës Themelore.
28. Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme ndaj Aktvendimit [PN. nr. 1070/2018] të Gjykatës Apelit, dhe Aktvendimit [Kp. nr. 1399/2018] të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal.
29. Më 7 mars 2019, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit (Pml. nr. 39/2-19) refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur kundër Aktvendimit [PN. nr. 1070/2018] të Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimit [Kp. nr. 1399/2018] të Gjykatës Themelore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

30. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 7 [Vlerat], 16 [Epërsia e Kushtetutës], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E drejta për Mjete Juridike], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës dhe me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPRK).
31. Parashtruesi i kërkesës ankohet para Gjykatës se gjykatat e rregullta kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike kur kanë llogaritur kohën e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak të tij në lidhje me rastin penal për të cilin ai është shpallur fajtor.
32. Ai pretendon se koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak, nga 28 korriku 2011 deri më 26 mars 2015, është monitoruar nga Policia e Kosovës, stacioni policor në Shtime dhe thekson se tani nga gjykatat e rregullta kjo *“interpretohet se ai nuk paska qenë i detyruar të qëndrojë në arrest shtëpiak”* pasi nuk ka pasur vendim gjyqësor për këtë.
33. Ai ankohet se e drejta e tij për një gjykim të drejtë është shkelur për faktin se gjykatat e rregullta në të gjitha procedurat nuk kanë vërtetuar faktet që vërtetojnë se atij gabimisht i është llogaritur koha e kaluar në arrest shtëpiak, dhe se ai në fakt ka qëndruar në arrest shtëpiak nga 28 korriku 2011 deri më 26 mars 2015 e jo nga 28 korriku 2011 deri më 12 dhjetor 2013, ashtu siç është konstatuar nga gjykatat e rregullta.
34. Ai po ashtu pretendon shkelje të barazisë para ligjit si pasojë e vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike pasi, sipas tij, përderisa të gjithë qytetarëve u llogaritet koha e qëndrimit në paraburgim dhe arrest shtëpiak në dënimin e shqiptuar për veprë penale, parashtruesit të kërkesës kjo nuk i është llogaritur, dhe kjo përbën *“një rast unikat në Kosovë”*.

35. Në lidhje me shkeljen e të drejtave të tjera kushtetuese, parashtruesi i kërkesës kryesisht përshkruan dispozitat e këtyre neneve dhe thekson se ai ka ofruar prova të mjaftueshme për të dëshmuar, përmes vërtetimit të lëshuar nga Stacioni Policor në Shtime, që ai ka qëndruar në arrest shtëpiak deri në vitin 2015, por kjo nuk është marrë parasysh nga gjykatat e rregullta, të cilat kanë konstatuar se për arrestin shtëpiak për të cilin pretendon parashtruesi i kërkesës, ai nuk ka vendim gjyqësor.
36. Për këtë arsye, parashtruesi i kërkesës i parashtron Gjykatës pyetjet në vijim: A është në përputhje me dispozitat e Kushtetutës dhe KEDNJ nëse një i pandehur i nënshtrohet arrestit shtëpiak dhe kjo nuk i llogaritet në dënim? A i është siguruar parashtruesit një gjykim i drejtë dhe i paanshëm? dhe, A është interpretimi i normës juridike që nuk lejohet rishikimi i procedurës kundër aktvendimit në përputhje me frymën e Kushtetutës dhe KEDNJ-së?
37. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon që kërkesa të shpallet e pranueshme; të konstatohet shkelje e neneve kushtetuese për të cilat ai pretendon si dhe të anulohen vendimet e kontestuar.

Pranueshmëria e kërkesës

38. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
39. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët parashohin që:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

[...]

40. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit, i cili parasheh:

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

41. Gjykata i referohet edhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]”

42. Gjykata po ashtu i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.”

43. Gjykata po ashtu i referohet paragrafëve (1) (c) dhe (3) (b) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, që parashohin:

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit, [...]”

(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse ndonjë nga kushtet në vijim është i pranishëm:

[...]

(b) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën; [...]”

44. Gjykata rikujton se në lidhje me rastin e parashtruesit të kërkesës janë zhvilluar tri procedura:

a) procedura me të cilën ai ishte shpallur fajtor për veprën penale vrasje e rëndë, në lidhje me të cilën procedurë Gjykata kishte nxjerrë Aktvendimin për papranueshmëri KIO6/15, të 14 korrikut 2016 dhe e cila nuk kontestohet nga parashtruesi i kërkesës në këtë rast;

b) procedura në lidhje me llogaritjen në dënim të kohës së paraburgimit dhe arrestit shtëpiak që kishte përfunduar me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [PN. nr. 817/16], të 30 nëntorit 2016; dhe

c) procedurën për rishikimin e procedurës penale në lidhje me Aktvendimin [PN. nr. 817/16] e Gjykatës së Apelit, të 30 nëntor 2016.

45. Parashtruesi konteston para Gjykatës procedurën *b)* dhe *c)*. Rrjedhimisht, Gjykata do të trajtojë këto dy procedura ndaras.

b) Procedura në lidhje me llogaritjen në dënim të kohës së kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak

46. Në lidhje me këtë procedurë, duke vlerësuar nëse janë plotësuar kriteret e pranueshmërisë të cekura më lart, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar e cila konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [PN. nr. 817/16] e Gjykatës së Apelit, të 30 nëntorit 2016, pasi i ka shteruar mjetet juridike të parapara me ligj, në pajtim me kërkesat e paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit.
47. Sa i përket afatit 4 (katër) mujor për paraqitjen e kërkesës të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit dhe Rregullin 39 pika (1) (c) të Rregullores së punës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [PN. nr. 817/16] e Gjykatës së Apelit, të 30 nëntorit 2016.
48. Gjykata rikujton se parashtruesi e parashtroi kërkesën e tij në Gjykatë më 11 qershor 2019. Gjykata më tej vëren se, edhe pse parashtruesi nuk ka cekur datën e pranimit të Aktvendimit të cekur më lart, Aktvendimi i kontestuar është kontestuar nga parashtruesi edhe para Gjykatës Themelore në kërkesën për rishikimin e procedurës penale, me të cilën kishte kërkuar rishikimin e Aktvendimit [P. nr. 592/2011] të Gjykatës Themelore, të 29 marsit 2016 dhe Aktvendimit [PN. nr. 817/16] të Gjykatës së Apelit, të 30 nëntorit 2016.
49. Meqenëse kërkesa për rishikimin e procedurës penale është parashtruar në Gjykatën Themelore më 11 shtator 2018, Gjykata konkludon se Aktvendimi i kontestuar i ishte dorëzuar parashtruesit para kësaj date. Në bazë të asaj që u tha më sipër, Gjykata konstaton se koha në mes të datës së pranimit të Aktvendimit të kontestuar, përkatësisht më së voni më 11 shtator 2018, dhe datës së parashtrimit të kërkesës së tij për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar në Gjykatën Kushtetuese, përkatësisht datës 11 qershor 2019, ka kaluar afatin prej 4 (katër) muajsh.
50. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit lidhur me procedurën për llogaritjen në dënim të kohës së paraburgimit dhe arrestit shtëpiak, që ndërlidhet me Aktvendimin [PN. nr. 817/16] e Gjykatës së Apelit, të 30 nëntorit 2016, është dorëzuar pas afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh.
51. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe të parandalohet mbajtja në gjendje pasigurie për një periudhë të gjatë kohore e palëve dhe personave të tjerë të përfshirë (shih, *mutatis mutandis* rastin *Sabri Güneş kundër Turqisë*, kërkesa nr. 27396/06, Aktgjykim i GJEDNJ-së, i 29 qershorit 2012, paragrafi 39; dhe, rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI140/13, *Ramadan Cakiqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 marsit 2014, paragrafi 24).

52. Nga kjo rrjedh se kjo pjesë e kërkesës së parashtruesit është dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, dhe si e tillë është e papranueshme.

c) Kërkesa për rishikimin e procedurës penale

53. Sa i përket kërkesës për përsëritje të procedurës penale, duke vlerësuar nëse janë plotësuar kriteret e pranueshmërisë të cekura më lart, Gjykata konstaton se parashtruesi ka parashtruar kërkesën si palë e autorizuar, e cila konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [PML. nr. 39/2019] e Gjykatës Supreme, të 7 marsit 2019, dhe ka parashtruar kërkesën brenda afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe pas shterjes së mjeteve juridike të parapara me ligj në pajtim me kërkesat e paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe nenit 47 të Ligjit. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit.
54. Në lidhje me këtë procedurë, parashtruesi pretendon se gjykatat e rregullta nuk kanë marrë për bazë faktet e paraqitura që dëshmojnë se ai ka qëndruar në paraburgim nga 28 korriku 2011 deri më 26 mars 2015, duke pretenduar shkelje të të drejtës për gjykim të drejtë sipas nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës. Si pasojë e mos marrjes parasysh të fakteve të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës që ndërlidhen me të drejtën për një gjykim të drejtë, ai pretendon se atij i janë shkelur edhe disa të drejta të tjera të parapara me Kushtetutë.
55. Rrjedhimisht, Gjykata duhet të vendos nëse në kërkesën e parashtruesit për rishikim të procedurën penale aplikohen garancitë e nenit 31 të Kushtetutës.
56. Gjykata vëren se në këtë procedurë, gjykatat e rregullta vendosin vetëm lidhur me përmbushjen e kërkesave procedurale për rishikimin e procedurës penale dhe jo për meritat e rastit.
57. Gjykata gjithashtu përsërit se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*
58. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikës gjyqësore të saj, përsërit se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së nuk zbatohen në kërkesat për rishikimin ose përsëritjen e procedurës (shih, në mënyrë analoge, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KIO7/17/15, *Pashk Mirashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 qershorit 2017, paragrafi 64; KI76/18, *Pjetër Boçi*, Aktvendim për papranueshmëri i 22 nëntorit 2018, paragrafi 67, shih gjithashtu rastet e GJEDNJ-se, *inter alia*, *Oberschlick kundër Austrisë*, nr. 23727/94, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 marsit 1994, *Dowsett kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 8559/08, Aktvendim për papranueshmëri i 4 janarit 2011, *Sablon kundër Belgjikës*, nr. 36445/97, Aktgjykim i 10 prillit 2001, paragrafi 86).

59. Për më tepër, Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së e cila konstaton se neni 6 i KEDNJ-së nuk zbatohet në procedurat për rishikimin e ndonjë rasti sepse një person vendimi i të cilit është bërë i plotfuqishëm dhe i cili bën kërkesë për rishikimin e rastit të tij nuk është "akuzuar për vepër penale" brenda kuptimit të atij neni (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese KI76/18, *Pjetër Boçi*, Aktvendim për papranueshmëri i 22 nëntorit 2018, paragrafi 68, si dhe rastin e GJEDNJ-së, *Franz Fischer kundër Austrisë*, nr. 27569/02, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 majit 2003).
60. Gjykata thekson se pajtueshmëria *ratione materiae* e kërkesës me Kushtetutën rrjedh nga juridiksioni material i Gjykatës. E drejta në të cilën thirret parashtuesi i kërkesës duhet të mbrohet me Kushtetutë, në mënyrë që një ankesë kushtetuese të jetë në pajtim *ratione materiae* me Kushtetutën. Megjithatë, Kushtetuta nuk i garanton parashtuesit të kërkesës të drejtën për rishikim ose përsëritje të procedurës (shih, në mënyrë analoge, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI07/17/15, *Pashk Mirashi*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 qershorit 2017, paragrafi 66; KI76/18, *Pjetër Boçi*, Aktvendim për papranueshmëri i 22 nëntorit 2018, paragrafi 69).
61. Prandaj, Gjykata konsideron se ankesat e parashtuesit lidhur me hedhjen poshtë të kërkesës së tij nga gjykatat e rregullta për të rishikuar procedurën penale nuk janë *ratione materiae* në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe si e tillë kjo pjesë e kërkesës deklarohet e papranueshme.

Përfundim

62. Gjykata në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 39 (1) (c) dhe (3) (b) konstaton se kërkesa e parashtuesit:
 - (i) lidhur me llogaritjen në dënim të kohës së paraburgimit dhe arrestit shtëpiak që kishte përfunduar me Aktvendimin [PN. nr. 817/16] e Gjykatës së Apelit, të 30 nëntorit 2016, është paraqitur jashtë afatit 4 (katër) mujor; dhe,
 - (ii) sa i përket pretendimit të parashtuesit të kërkesës lidhur me rishikimin e procedurës penale kërkesa nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) dhe (3) (b) të Rregullores së punës, më 10 shtator 2019, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Laban Radomir
Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi
Arta Rama-Hajrizi